

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"DEMETJA CONSTRUCTION" sh.p.k.**

Në Tiranë, sot me datë 31.10.2023, (dymijë e njezet e tre), Ne te nënskruarit e mëposhtëm:

**Rezart DEMETJA**, atësia Muharrem, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Rruga e Dibrës; Nd. 10; H. 5; Ap. 26; Tiranë, lindur më 29/04/1976, mbajtes i Leternjoftimit me nr. personal H65429125K,

**Lorenc DEMETJA** atësia Muharrem, amësia Shpresa, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rruga Haxhi Hysen Dalliu; Nd. 57; H. 1; Ap. 21; Tiranë, lindur më 19/01/1984, mbajtes i Leternjoftimit ID me nr. personal I40119055B,

*me cilësinë e "Ortakëve Themelues", redaktohet akti, nëpërmjet të cilët deklarojme se me vullnet të lire të plote e të sinqertë, dhe inisiativen e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet përkatëse, në ligjin "Për QKB", në Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojmë shoqerinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "**DEMETJA CONSTRUCTION**" sh.p.k.*

**KREU I**

**Emërtimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**DEMETJA CONSTRUCTION**" sh.p.k.

**Neni 2**

**Forma Juridike**

Shoqëria "**DEMETJA CONSTRUCTION**" sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizik të sipërpërmendur, të cilët nuk përgjigjen pér detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënskruara.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve pér detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarisë së saj.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka selinë në, Tirane, Katund i Ri, Kashar, ZK 2119, Numri i Pasurisë 208/16/14.



Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 4**

**Objekti**

Aktiviteti ne fushen e, ndertimit, transportit.

Ne fushen e ndertimit shoqëria do te kryeje: Studimin,projektimin,konsulencen,vleresime te pasurive te paluajtshme, siper Marrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde



publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose adminstrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin e ndertesave nje dhe shume kateshe, publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, objektet industriale, etj, te gjitha restaurimet ne per gjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike.

Ne fushen e tregtise shoqeria do te krye: Tregtimin dhe import - eksportin e mallrave te ndryshem si, material ndertimi, Industriale e artikujve te ndryshem paisje elektrike, mekanike, elektronike, bojrade te ndryshme me baze ujore dhe baze vajore per lyerje te fasadave te murit, te drurit te hekurit etj, stuko patinimi koll, tregtimin e pasurive te luajtshme e te paluajtshme, shitblerjen e tokes, tregtimin e mallrave te gatshem e gjysem te gatshme etj.

Transport te materialeve te ndryshme dhe mbetjeve (urbane te rrezikshme).

Shitblerje dhe dhenie me qera te makinerive e pajisjeve te punes dhe pasuri te paluajtshme.

Import – Eksport shitje me shumice e pakice, material elektrike, ndertimi, industrial, hidroteknike, kimikate, karburante e lende djegese, lubrifikante, pjese kembimi auto, pajisje teknologjike mjedisore, makineri e pajisje te cdo lloji.

Studim, projektim, konsulence, raporte, ndertim ne fushat energjetike, mjedis, ujesjelles kanalizime, hidroteknike dhe sektore te tjera te industrise.

Supervizim, mbikqyrje punimesh, shfrytezim i vendburimeve minerare te ngurta e te lengeta, perpunim mineralesh, inertesh, hapje puse uji.

#### Neni 5

#### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

#### KREU II KAPITALI

#### Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerisë është **100.000 (njëqind mijë) lekë** dhe është i përbërë nga **2 kuota**.

Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, ndahet në 2 kuotë me vlerë, që përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë, që zotërohet nga Ortaket e shoqerise te ndarë në dy kuota, si më poshtë:

- 1- **REZART DEMETJA**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 50 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme 50.000 (pesedhjete mijë) lekë.
- 2- **Lorenç DEMETJA**, zotëruesi i 1 kuote, që përbën 50 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithëshme 50.000 (pesedhjete mijë) lekë

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

#### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mundtë fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilësuar që kerkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8**

###### **Organë Vendimmarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

##### **Neni 9**

###### **Marrja e vendimeve**



Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave te zoteruesve te kapitalit te shoqerise, qe jane pjesmarres ne mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 10

### Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. **REZART DEMETJA** i cili do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë **5 vjecare me të drejtë ripërtëritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.


Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të janë të pakufizuara dhe çdo ndryshim i tyre njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Administratorët mund të përfaqësojnë shoqërinë së bashku ose veç njëri nga tjetri dhe mund të prokurojnë të tretë përfaqësim të tyre. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## Neni 11

### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të regjullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raportojë përrpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori eshte i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe ne rastet kur :
- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe



- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 12

##### Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

#### Neni 13

##### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

#### Neni 14

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 15

##### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

#### Neni 16

**Dispozita përfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga ortaku i vetem i shoqërisë tregtare, nënshkruan në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij orgjinale.

***ORTAKET E SHOQËRISË***

**REZART DEMETJA**

*Rozeta Demetja*

**LORENC DEMETJA**

*Lorenc Demetja*